

Në bazë të nenit 111-a paragrafi (4) dhe 111-b paragrafi (2) nga Ligji për prokurimin publik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (*) („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.180/19 dhe 176/21), ministri i mbrojtjes miratoi

RREGULLORE

Mbi formën dhe përmbajtjen e kërkesës për regjistrim në regjistrat e operatorëve ekonomik, mënyra e mbajtjes së regjistrave, përmbajta e regjistrave, forma dhe përmbajtja e vërtetimit për regjistrim në regjistrat e operatorëve ekonomik, mënyra e disponueshmërisë së informacionit aktual të prokurimit për nevojat e organizatës së traktatit të Atlantikut të veriut dhe shteteve anëtare të saj në varësi të shkallës së klasifikimit.

Neni 1

Kjo rregullore përshkruan formën dhe përmbajtjen e kërkesës për regjistrim në regjistrat e operatorëve ekonomikë, mënyrën e mbajtjes së regjistrave, përmbajtjen e regjistrave, formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për regjistrim në regjistrat e operatorëve ekonomikë, si dhe mënyra e disponueshmërisë së informacionit aktual të prokurimit për nevojat e organizatës së traktatit të atlantikut të veriut (në tekstin e mëtejme: NATO) dhe shteteve anëtare të saj në varësi të shkallës së klasifikimit.

Neni 2

Operatorët ekonomikë që janë të interesuar të regjistrohen në regjistrat e operatorëve ekonomikë, paraqesin një kërkesë për regjistrim në regjistrat e operatorëve ekonomikë, në arkivin e Ministrisë së mbrojtjes (në tekstin e mëtejme: Ministria) ose në e-mail adresën: natonabavki@mod.gov.mk. në Shtojcën nr.1 e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Regjistrimet e operatorëve ekonomikë mbahen në formë elektronike në Ministri.

Me marrjen e kërkesës të përmendur në nenin 2 të kësaj Rregulloreje, do të kontrollohet plotësia e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues.

Nëse mungon një pjesë e dokumentacionit shoqërues, aplikanti njoftohet menjëherë përmes adresës së postës elektronike të specifikuar në aplikim. Dokumentacioni shoqërues duhet të dorëzohet jo më vonë se tre ditë pune nga marrja e njoftimit.

Pas plotësimit të dokumentacionit shoqërues të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, operatori ekonomik regjistrohet në regjistrat e operatorëve ekonomikë.

Neni 4

Regjistrimet e operatorëve ekonomikë përmbajnë të dhënat e mëposhtme : emrin e shoqatës tregtare ; numrin i vetëm tatimor i shoqatës ; numrin personal I subjektit ; aktivitetin e regjistruar të shoqatës tregtare ; adresa; përkatësisht zyra e regjistruar; personi i kontaktit; numri i telefonit; e-mail; uebfaqja e operatorit ekonomik; numri serik dhe vlefshmëria e certifikatës së sigurisë për personin juridik dhe numri serik dhe vlefshmëria e certifikatës së sigurisë për secilin individ.

Neni 5

Forma dhe përmbajtja e certifikatës për regjistrim në regjistrat e operatorëve ekonomikë jepen në Shtojcën nr. 2 e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Prokurimet e vazhdueshme për nevojat e NATO -s dhe shteteve anëtare të saj, pa treguar shkallën e klasifikimit, vihen në dispozicion të publikut të gjerë përmes publikimit të tyre në faqen e internetit të Ministrisë.

Prokurimet aktuale për nevojat e NATO -s dhe shteteve anëtare të saj, në varësi të nivelit të klasifikimit të informacionit që përmbajnë, janë të disponueshme vetëm për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat e operatorëve ekonomikë të mbajtur nga Ministria.

Në varësi të nivelit të certifikatës së sigurisë që ata posedojnë, për operatorët ekonomikë nga paragrafi 2 i këtij neni, në dispozicion janë informacionet e mëposhtme:
për prokurimin për nevojat e NATO -s dhe vendeve anëtare të saj me etiketë:

„NATO – Unclassified“, informacioni mund të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë, por vetëm në pjesën në të cilën kanë qasje vetëm subjektet e regjistruara në evidence

- për prokurimin për nevojat e NATO -s dhe vendeve anëtare të saj me etiketë :

„NATO – Restricted“, informacioni nuk publikohet në faqen e internetit të Ministrisë

- për prokurimin për nevojat e NATO -s dhe vendeve anëtare të saj me etiketë :

„NATO – Confidential“, „ NATO – Secret“ dhe „ NATO – CosmicTopSecret“, informacioni u jepet vetëm subjekteve të regjistrave që kanë një certifikatë të përshtatshme sigurie.


Informacioni i referuar në paragrafin 3 të këtij neni është i disponueshëm për operatorët ekonomikë në përputhje me aktivitetin për të cilin janë regjistruar subjektet nga regjistrat dhe në përputhje me rregulloret në fushën e informacionit të klasifikuar dhe jepen për secilën prokurim veç e veç.

Neni 7

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi ditën pas botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 01-5645/1
Data 07.09.2021

Ministri i mbrojtjes
Radmilla Shekerinska Jankovska



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E MBROJTJES

KËRKESË PËR REGJISTRIM NË REGJISTRAT E OPERATORËVE EKONOMIKË

Emri i shoqatës tregtare	
Numri unik tatimor i shoqatës tregtare	
Numri amë i subjektit	
Adresa/Selia	
Personi për kontakt	
Numri i telefonit	
Posta elektronike	
Faqja e internetit e shoqatës tregtare	
Vërejtje	
Dokumente shtesë (shënohet dokumenti që dorëzohet)1	
<ul style="list-style-type: none">- Deklarata e dhënë nën përgjegjësinë morale, materiale dhe penale e nënshkruar dhe verifikuar nga vetë operatori ekonomik, e cila dëshmon se në pesë vitet e fundit ai nuk është dënuar për pjesëmarrje në ndonjë organizim kriminal, korruptiv, mashtrues ose për pastrim parash; <input type="checkbox"/>- Vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent si dëshmi se nuk është hapur procedurë falimentimi; <input type="checkbox"/>- Vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent si dëshmi se nuk është hapur procedurë likuidimi; <input type="checkbox"/>- Gjendja aktuale e subjektit; <input type="checkbox"/>- Vërtetim për veprimtarinë e regjistruar (DVR); <input type="checkbox"/>- Vërtetim i lëshuar nga autoriteti kompetent si dëshmi e tatimeve dhe kontributeve të paguara; <input type="checkbox"/>- Vërtetim i lëshuar nga organi kompetent për mbajtjen e regjistrave në të cilat shënohen gjobat si dëshmi se operatori ekonomik nuk është gjobitur për pjesëmarrje në procedurat e thirrjeve publike, dhënien e kontratave të prokurimit publik dhe kontratat e partneritetit publik-privat; <input type="checkbox"/>- Vërtetim i lëshuar nga organi kompetent për mbajtjen e regjistrave në cilat shënohen gjobat, si dëshmi se operatorit ekonomik nuk i është shqiptuar gjobë me ndalesë të përkohshme për kryerjen e një veprimtarie të caktuar; <input type="checkbox"/>- Vërtetim i lëshuar nga organi kompetent për mbajtjen e regjistrave në të cilat shënohen gjobat, si dëshmi se operatorit ekonomik nuk i është shqiptuar gjobë me ndalesë dytësore për kryerjen e një veprimtarie të caktuar; <input type="checkbox"/>- Vërtetim se nuk është shqiptuar asnjë sanksion kundërvajtës me aktgjykim të plotfuqishëm, si dëshmi se operatorit ekonomik nuk i është ndaluar kryerja e profesionit, veprimtarisë ose detyrës; <input type="checkbox"/>- Vërtetim se nuk është shqiptuar asnjë sanksion kundërvajtës me aktgjykim të plotfuqishëm, si dëshmi se operatorit ekonomik nuk i është ndaluar kryerja e një veprimtarie të caktuar; <input type="checkbox"/>	

- Vërtetim i sigurimit përkatës të kompensimit në raste të rrezikut profesional;
- Raport i bilancit të gjendjes i vërtetuar nga autoriteti kompetent, gjegjësisht bilancit të audituar, ose fragmente nga raporti i bilancit të gjendjes;
- Lista e shitjeve kryesore të bëra në tre vitet e fundit, me vlerat, datat, blerësit (autoritetet kontraktuese ose operatorët ekonomikë), duke siguruar një konfirmim të dërgesave të lëshuara nga blerësit ose një deklaratë të shitjeve të kryera;
- Përshkrimi i teknikës dhe aftësisë së operimit të operatorit ekonomik, masat për sigurimin e cilësisë dhe pajisimi dhe aftësimi i subjektit për ekzaminim dhe hulumtim, përmes deklaratës;
- Deklaratë për personelin teknik të punësuar dhe organet teknike pavarësisht nëse i përkasin drejtpërdrejt operatorit ekonomik;
- Nëse posedoni çertifikatë sigurie për një person juridik, Deklaratë për mbajtësin e certifikatës së sigurisë me shkallën e specifikuar të të dhënave të klasifikuara, numrin serik dhe vlefshmërinë e çertifikatës së sigurisë;
- Nëse posedoni çertifikatë sigurie për persona fizik, për secilin person fizik individualisht Deklaratë për mbajtësin e certifikatës së sigurisë me një shkallë të caktuar të të dhënave të klasifikuara, numrin serik dhe vlefshmërinë e çertifikatës së sigurisë.

Data

Nënshkrim i kërkesit,

¹ Dokumentet e bashkangjitura kërkesës nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj nga dorëzimi i kërkesës. Ato dorëzohen në original ose formë elektronike në pdf.